



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 87-të, të mbajtur më 01.06.2023, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-306/1 të datës 20.01.2021, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja vërtetoi se në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, nuk ka elemente për veprim kompetent sipas lëndës për arsye që vlerësoi se organe tjera janë kompetente për të vepruar.

Lënda me numër 12-306/1 të datës 20.01.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb-faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më 20.01.2021 është dorëzuar denoncim dhe është formuar lënda me numër 12-306/1 të datës 20.01.2021.

Në denoncim, parashtruesi thekson se deri në vitin 2016, përmes kompanisë së tij, ka ofruar shërbime televizive kablore dhe interneti përmes rrjetit të tij për përdoruesit fundorë. Pasi personit juridik i janë vjedhur disa herë pajisjet në posedim, ai është detyruar të paraqitet në komisariatit e Gazi Babës, ku është këshilluar që të marrë një avokat -----, të cilët kishin përvojë në procedura të tilla.

parashtruesi, i cili paraprakisht kishte dorëzuar kallëzim penal në prokurorinë publike themelore kompetente dhe padi në gjykatën kompetente, avokatin e lartpërmendur e kishte angazhuar për shkak të nevojës për ndihmë juridike. Ai thekson se avokati ka vepruar në atë mënyrë që ka dëmtuar interesat e tij juridike në procedurë, si rezultat i së cilës kundër ankuesit është ngritur kallëzim penal dhe është shqiptuar dënim me kusht dhe gjobë.

Për shkak të sjelljes së tillë të avokates, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kallëzim penal kundër saj, e cila është refuzuar nga Prokuroria Themelore Publike Shkup, ndërsa pas ankesës Prokuroria e Lartë Publike Shkup ka konfirmuar vendimin e organit të shkallës së parë. Ai ka paraqitur kallëzim penal edhe kundër menaxherit të personit juridik privat i cili sipas

pretendimeve në kallëzim është fajtor për vjedhjen e pajisjeve të kompanisë së tij, ndërsa Prokuroria Themelore Publike Shkup me aktvendim e ka refuzuar kallëzimin penal dhe procedurën ankimore në Prokurorinë e Lartë Publike Shkup ishte në vazhdim e sipër.

Ka dorëzuar kallëzim penal edhe ndaj një personi fizik, i cili më parë ka punuar në kompaninë e tij, për shkak të pretendimeve se është fajtor edhe për vjedhjet e sipërpërmendura të pajisjeve. Ndaj parashtruesit është zhvilluar procedurë edhe në Gjykatën Themelore të Shkupit, lidhur me mbledhjen e borxhit, në të cilën pjesërisht është pranuar kërkesa e paditësit. Pas paraqitjes së ankesës në Gjykatën e Apelit në Shkup, gjykata e konfirmoi aktgjykimin e shkallës së parë. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga KSHPK-ja që në procedurën e përmendur të ndërmarrë veprime kundër veprimeve të papërshtatshme të avokatit në fjalë, ndaj veprimeve të Prokurorisë Themelore Publike Shkup, Prokurorisë së Lartë Publike Shkup, Gjykatës Themelore Shkup dhe Gjykatës së Apelit Shkup.

Pas shqyrtimit të pretendimeve përkatëse, DHPGJS-ja ka konstatuar se nuk ka elemente për veprim kompetent në rastin konkret dhe parashtruesi i kërkesës i drejtohet rastit organeve kompetente: Odës së Avokatëve të Republikës së Maqedonisë, Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar:  
- Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.K.SH  
Miratoi: G.T, anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËTOR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Nënkryetar,  
Katica Nikolovska